



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-30547/23 datë:17.11.2023



Npi – 01/433 datë: 27.11.2023

Bazuar në: Nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 5 të Udhëzimi Administrativ të (MPL) Nr.05/2020 Për Procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 27.11.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR PLOTËSIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA ME
ZEJNIJE VELIU**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më: 27.11.2023, me shumicën e votave miratoi vendimin për plotësimin e KPF-së me anëtarin e re, znj.Zejnije Velu nga Shtimja.

II

A r s y e t i m: Anëtarja e Kuvendit, përkatësisht e Komitetit për Politikë dhe Financa, znj.Heroina Selmani nga Shtimja, anëtare e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me dëshirën e sajë ka dhënë dorëheqje nga posti i anëtares të Kuvendit të Komunës së Shtimes përkatësisht anëtares të Komitetit për Politikë dhe Financa, më 15.11.2023, me arsyetim se gjendet jashtë vendit.

Me Vendimin e KQZ-së Nr.01/1443/22 të datës 24.11.2022, znj.Heroina Selmani është zëvendësuar me anëtarin e re znj.Zejnije Velu nga Shtimja, nga subjektit politik Vetëvendosje. Për zëvendësimin e znj.Heroina Selmani në Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendi në mbledhjen e mbajtur më 27.11.2023 me 11 vota “Për” me 10 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstënim” mori vendim që të zgjedh znj.Zejnije Velu, anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi